



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 240/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.04.2019 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: “Shfuqizimi i procesit dhe mënyrës së vlerësimit dhe klasifikimit të ofertave të datës 05.03.2019 të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me procedurën e prokurimit me Nr.REF- 08993-02-18-2019, me objekt: “*Blerje kancelari (bojra + leter format,etj) për Bashkinë dhe Njësitë e Varësisë per vitin 2019*”, “Marrëveshje kuadër”, me fond limit 1 315 864 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 01.03.2019 nga autoriteti kontraktor Bashkia Librazhd.”

Ankimues: “Infosoft Office” sh.p.k
Autostrada Tiranë-Durrës, Km 8, Kashar, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Librazhd
Sheshi “Gjorg Golemi”, Librazhd

Subjekte të Interesuar “Artan Llozana” p.f
L. “A.Pasha”, Rr. “Rinia”, Elbasan

“Ruzhdije Cota” p.f
L.1, Rr. “Ardian Edgar”, Ndërtesë private nr.3, Librazhd

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 19.02.2019 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr.REF- 08993-02-18-2019, me objekt: “Blerje kancelari (bojra + leter format,etj) për Bashkinë dhe Njësitë e Varësisë per vitin 2019”, “Marrëveshje kuadër”, me fond limit 1 315 864 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 01.03.2019 nga autoriteti kontraktor Bashkia Librazhd.

II.2. Në datën 05.03.2019 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si më poshtë:

- | | |
|-----------------------------|------------------------------|
| 1. “Artan Llozana” p.f | 1.000.833 lekë, kualifikuar |
| 2. “Interlogistic” sh.p.k | 1.058.808 lekë, skualifikuar |
| 3. “Adastra” sh.p.k | 1.068.000 lekë, skualifikuar |
| 4. “Ruzhdije Cota” p.f | 1.281.948 lekë, kualifikuar |
| 5. “Infosoft Office” sh.p.k | 1.287.026 lekë, kualifikuar |

II.3. Në datën 11.03.2019 operatori ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kundërshtuar procesin e krahasimit të ofertave, në procedurën e prokurimit.

Konkretisht pretendohet si vijon:

“Në Njoftimin e Kontratës thuhet:

2.4 Lloji i Marrëveshjes Kuadër

Me një Operator Ekonomik

Me disa operatorë ekonomikë

Të gjitha kushtet janë të përcaktuara Po Jo

2.5 Numri i operatorëve ekonomikë me të cilët do të përfundojë Marrëveshja Kuadër: _____ (Këtu duhet të përcaktohet numri maksimal i operatorëve ekonomikë me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër).

2.6	Kushtet që do zbatohen në rastin e rihapjes së konkurimit dhe/ose përdorimi i mundshëm i blerjes elektronike .	Nuk do të ketë rihapje të konkursit. Kontratat do të lidhen sipas kërkesave të AK, me operatorin ekonomik me të suksesshëm, i cili do të ofrojë çmimin me të ulët të ofertës.(Oferta do të paraqitet si shumatore e çmimeve për njësi të përlogaritur për cdo artikull dhe vlera totale e ofertës gjithashtu) Dhënia e kontratave do të bëhet nga Bashkia Librazhd.
-----	--	--

Shuma totale e çmimeve për njësi: 225 687.3(dyqind e njezet e pese mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e shtatë pike tre) lekë pa tvsh.

4.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) çmimi më i ulët

Duke qënë se mënyra e përzgjedhjes së fituesit ishte e paqartë për ne, me datë 22.02.2019 ju drejtuam faqes së APP-së me një kërkesë për sqarim , ku ndër të tjera ju pyesnim:

“Ju lutemi na sqaroni:

Fitues shpallet OE që ka shumatoren e çmimeve për njësi të përlogaritur për cdo artikull më të vogël, apo vlerën totale më të vogël?”

Në datën 26.02.2019, po përmes faqes së APP-së, morën sqarimin tuaj ku thuhet:

Kontratat do të lidhen sipas kërkesave të AK, me operatorin ekonomik më të suksesshëm, i cili do të ofrojë çmimin më të ulët të ofertës. Oferta do të paraqitet si shumatore e çmimeve për njësi të përlogaritur për cdo artikull. Vlera totale e ofertës nuk duhet të tejkalojë vlerën e fondit limit, për këtë arsye është përcaktuar që OE mund të paraqesin preventivin edhe në vlerën totale të ofertës ekonomike, por kriter kryesor do të jetë shumatorja e çmimeve për njësi, përderisa kemi përzgjedhur llojin e procedurës së prokurimit, kërkesë për propozim-marrëveshje kuadër.

Pra renditja e OE, dhe natyrisht shpallja e fituesit, do të bëhej referuar shumatores së çmimeve për njësi, sic përcakton edhe LPP-ja.

Klasifikimi që ju keni publikuar me datë 05.03.2019 bazohet në vlerat totale të ofertave pa tvsh, pra është klasifikim i gabuar.

Bazuar në LPP, rregullat e prokurimit publik, përcaktimeve që ju vetë keni vendosur për këtë tender, sqarimeve që na dhatë si edhe përcaktimeve ligjore për funksionimin e marrëveshjeve kuadër, kërkojmë nxjerrjen e një klasifikimi të ri, ku të renditen shumatorët e cmimeve për njësi, pasi i vetmi kriter vlerësimi është shumatorja dhe jo vlera totale e ofertës. [...].

II.5. Nëpërmjet shkresës Nr 1473/1 Prot., datë 11.03.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit, duke e refuzuar ankesën, me argumentat si vijon:

“[...] KSHA gjykon se mënyra e vlerësimit të ofertave ekonomike të të gjithë OE është e drejtë, e saktë dhe ligjore. Oferta e OE “Infosoft Office” sh.p.k është kualifikuar si e rregullt dhe ofertë e suksesshme, por është oferta më e lartë në renditjen e ofertave të operatorëve ekonomikë. Pavarësisht këtij ankimi administrativ pranë AK, oferta e OE “Infosoft Office” sh.p.k është kualifikuar dhe nuk duket i bazuar ky ankim pranë AK, pasi KVO në cdo rast ka zbatuar LPP dhe RRPP. Fakti që KVO ka vendosur në kuotimin ekonomik vlerën totale të ofertës ka të bëjë me faktin e përzgjedhjes së marrëveshjes kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

Në pikën 2.6 të DST është përcaktuar se:

2.6	Kushtet që do zbatohen në rastin e rihapjes së konkurimit dhe/ose përdorimi i mundshëm i blerjes elektronike .	<p>Nuk do të ketë rihapje të konkursit.</p> <p>Kontratat do të lidhen sipas kërkesave të AK, me operatorin ekonomik me të suksesshëm, i cili do të ofrojë cmimin me të ulet të ofertës.(Oferta do të paraqitet si shumatore e cmimeve për njësi të përllogaritur për cdo artikull dhe vlera total e ofertes gjithashtu)</p> <p>Dhënia e kontratave do të bëhet nga Bashkia Librazhd.</p>
-----	--	---

Sa më sipër, KSHA i bën me dije OE “Infosoft Office” sh.p.k se oferta ekonomike, e paraqitur në SPE, është oferta me cmimin më të lartë dhe nuk e gjykon të drejtë të bëjë një klasifikim të ri.”

II.6. Në datën 20.03.2019 operatori ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt si edhe në autoritetin kontraktor.

II.7. Në datën 03.04.2019 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 509/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 1883/1 prot., datë 29.03.2019, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Infosoft Office” sh.p.k se: “[...] renditja e OE, dhe natyrisht shpallja e fituesit, do të bëhej referuar shumatores së cmimeve për njësi, sic përcakton edhe LPP-ja. Klasifikimi i publikuar me datë 05.03.2019 bazohet në vlerat totale të ofertave pa tvsh, pra është klasifikim i gabuar. Bazuar në LPP, rregullat e prokurimit publik, përcaktimeve të vendosura për këtë tender, sqarimeve që na dhatë si edhe përcaktimeve ligjore për funksionimin e marrëveshjeve kuadër, kërkojmë nxjerrjen e një klasifikimi të ri, ku të renditen shumatorët e cmimeve për njësi, pasi i vetmi kriter vlerësimi është shumatorja dhe jo vlera totale e ofertës [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1 Në “Njoftimin e kontratës” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, është përcaktuar:

“2.3 Kontratë në bazë të Marrëveshjes Kuadër

Po X Jo

2.4 Lloji i Marrëveshjes Kuadër

Me një Operator Ekonomik X

Me disa operatorë ekonomikë

Të gjitha kushtet janë të përcaktuara Po X Jo

2.5 Numri i operatorëve ekonomikë me të cilët do të përfundojë Marrëveshja Kuadër: _____ (Këtu duhet të përcaktohet numri maksimal i operatorëve ekonomikë me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër).

2.6	Kushtet që do zbatohen në rastin e rihapjes së konkurimit dhe/ose përdorimi i mundshëm i blerjes elektronike .	Nuk do të ketë rihapje të konkursit. Kontratat do të lidhen sipas kërkesave të AK, me operatorin ekonomik me të suksesshëm, i cili do të ofrojë cmimin me të ulët të ofertës.(Oferta do të paraqitet si shumatore e cmimeve për njësi të përlogaritur për çdo artikull dhe vlera totale e ofertës gjithashtu) Dhënia e kontratave do të bëhet nga Bashkia Librazhd.
-----	--	---

2.7 Autoriteti kontraktor/Autoritetet kontraktore, të cilat do të lidhin marrëveshjen kuadër: BASHKIA LIBRAZHD

2.8 Përshkrim i shkurtër i kontratës

Fondi limit: 1 315 864(një milion e treqind e pesëmbëdhjetë mijë e teteqind e gjashtëdhjetë e kater) leke pa tvsh.

2.Burimi i Financimit : Buxheti i Shtetit.

3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër : Blerje kancelari (bojra + leter format,etj) për Bashkinë dhe Njesite e Varesise për vitin 2019 ”.

Shuma totale e cmimeve për njësi: 225 687.3(dyqind e njetzet e pese mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e shtate pike tre) lekë pa tvsh.”

4.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) çmimi më i ulët X

Në shtojcën 1 “Formulari i ofertës ekonomike” është parashikuar:

Emri i Ofertuesit _____

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH

Nr	Emertimi I mallit	TOTALI	
			Njesia
1	Leter format Double A4	680	pako/risma
2	Leter A3 DoubleA (ose equivalente)	15	Pako
3	Leter format A4 color	10	pako
4	Urdher dorezimi me tre kopje	60	cope
5	Flete Hyrje me tri kopje	25	cope
6	Flete Dalje me tri kopje	55	cope
7	Dosje te thjeshta kartoni	800	cope
8	Dosje plastike me llastik	280	cope
9	Kuti Arshive	100	cope
10	Zarfa te vegjel 11X23	1700	cope
11	Zarfa te mesem	1300	cope
12	Zarfa te medhenj A4	950	cope
13	Stilolapsa cilesore blu	400	cope
14	Lapsa plumbi Mentor HB2	100	cope
15	Libra protokolli	28	cope
16	Liber dorezimi ne poste	18	cope
17	Regjister themeltar I punonjesve	5	cope
18	CDR-Verbatim	200	cope
19	Tela kapse 24/6	100	cope
20	Makine kapse 24/6 metalike	10	cope
21	Boje vule	12	cope
22	Vizore e madhe 30cm	5	cope
23	Qese plastike A4	50	Pako(me 100 cope)
24	Blloqe stick notes 76x76	100	cope
25	Libra magazine	10	cope
26	Dosje me mekanizem me kuti	200	Cope
27	Kapese aktesh te # cilesore	50	pako
28	Shina per dosje A4 11mm	2	Pako(100 cope)
29	Shina per dosje A4 15mm	2	pako(100 cope)
30	Kapak plastike A3 per shina	2	pako(100 cope)

31	Karton A4 160 gr	2	pako(100 cope)
32	Kapak plastike A4 per shina	2	pako(100 cope)
33	Kapse Binder clips 50 mm	50	cope
34	Kapse Binder clips 40 mm	50	cope
35	Ngjites stick(buzekuq) 21 gr	2	Pako(12 cope)
36	Boje printeri OKI B411 DN	4	cope
37	Epson L360 (661-662-663-664) set	4	cope
38	Lexmark 317DN	4	cope
39	Makinet Hapese vrimash (HoleMaker)	4	cope
40	Lexmark MS312DN (50F1H00, 5000 PAGES)	7	cope
41	RICOH SP 211	17	cope
42	HP 1280 ,45	1	cope
43	HP 78 C6578AN	1	cope
44	HP 7612 inkjet (CN053A BLK, CN054A,CN055A,CN056A)	3	set
45	Lexmark E 260 dn (E260A11E, 3500PAGES ËITH 5% COVERAGE)	2	cope
46	Boje printeri RICOH Aficio AP 410N	1	cope
47	Koycera fs 6525 TK475 (15000 PAGES ËITH 5% 1T02K30NL0)	14	cope
48	Koycera task alfa 2200 High Capacity	9	cope
49	Boje printeri HP Laser Jet 1022, Q2612X	2	cope
50	Boje fotokopjuesi Toshiba 167 (6AJ00000024 T-1640E-24K)	2	cope
51	Boje Printeri Samsung ML-2010 PR	2	cope
52	Boje XEROX 5019	4	cope
53	Boje Toshiba 262 Color	1	Set(cope 4)
54	Makine Llogarites Truly e madhe	5	cope
55	Rapidografe	10	cope
56	Boje Fotokop XEROX versalin b7030	1	cope
57	Shenjues letrash me ngjyra	40	pako
58	text marker	20	cope
59	Korrektore	3	Pako (12 cope)
60	Bllok Axhende Cilesore	10	cope
61	RICOH SP 201	2	cope
62	heqese teli cilesore	5	cope
63	prefese lapsash	10	cope
64	Mbajtese skoci mesatare	5	cope
65	Makine kapse tavoline metalike, cilesore	1	cope
	Totali PA TVSH		
	TVSH		
	TOTALI ME TVSH		

III.1.2. Në datën 26.02.2019 autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE një shtojcë, në të cilën jepen sqarimet si më poshtë vijon:

Lenda : SQARIM PER TE GJITHE OE TE INTERESUAR

Objekti: “ Blerje kancelari (bojra + leter format,etj) per Bashkine dhe Njesite e Varesise per vitin 2019”.

• **Per te gjithë operatorët e interesuar**

Autoriteti kontraktor Bashkia Librazhd, në mbështetje të nenit 42 të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”(i ndryshuar), V.K.M nr.914/2014 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” , duke marrë shkas nga kerkese për sqarim nga Operatorët ekonomike, sqaron të gjithë operatorët ekonomike të interesuar për këtë procedurë prokurimi si më poshtë vijon ;

1.

Nr.	Pershkrimi	Sasia	Njesia	Sqarim
43	HP 78 C6578AN	1	cope	HP 78 (High Yeild kapacitet XL)
49	Boje printeri HP Laser Jet 1022, Q2612X	2	cope	Boje printeri HP Laser Jet 1022 (High Yield kapacitet XL)

2. Percaktimi në DST se kontratat do të lidhen sipas kërkesave të AK, me operatorin ekonomik me të suksesshëm, i cili do të ofrojë cmimin me të ulët të ofertës. (Oferta do të paraqitet si shumatore e cmimeve për njësi të përlllogaritur për çdo artikull dhe vlera totale e ofertes gjithashtu)

Dhënia e kontratave do të bëhet nga Bashkia Librazhd, sqarojme të gjithë operatorët ekonomike si më poshtë vijon:

Kontratat do të lidhen sipas kërkesave të AK, me operatorin ekonomik me të suksesshëm, i cili do të ofrojë cmimin me të ulët të ofertës. Oferta do të paraqitet si shumatore e cmimeve për njësi të përlllogaritur për çdo artikuj. Vlera totale e ofertes nuk duhet të tejkalojë vlerën e fondit limit, për këtë arsye është percaktuar që OE mund të paraqesin preventivin edhe në vlerën totale të ofertes ekonomike, por kriter kryesor do të jetë shumatorja e cmimeve për njësi, përderisa kemi për zgjedhur llojin e procedurës së prokurimit, kerkese për propozim – marrëveshje kuader.

III.1.3. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se autoriteti kontraktor ka bërë vlerësimin dhe krahasimin e ofertave të paraqitura, bazuar në cmimin total të ofertave, pa tvsh, si vijon:

- | | |
|-----------------------------|------------------------------|
| 1. “Artan Llozana” p.f | 1.000.833 lekë, kualifikuar |
| 2. “Interlogistic” sh.p.k | 1.058.808 lekë, skualifikuar |
| 3. “Adastra” sh.p.k | 1.068.000 lekë, skualifikuar |
| 4. “Ruzhdije Cota” p.f | 1.281.948 lekë, kualifikuar |
| 5. “Infosoft Office” sh.p.k | 1.287.026 lekë, kualifikuar |

III.1.4. Në nenin 35/1, pika 5 dhe 8 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht: “Kur një marrëveshje kuadër arrihet me një operator të vetëm ekonomik, kontratat e bazuara në këtë marrëveshje lidhen brenda kufijve dhe kushteve të parashtruara në marrëveshjen kuadër. Për prokurimin e këtyre kontratave, autoriteti kontraktor komunikon me shkrim me operatorin palë në marrëveshjen kuadër, duke i kërkuar atij të plotësojë ofertën, në përputhje me kërkesat.”

“Në çdo rast, marrëveshja kuadër zbatohet sipas përcaktimeve të parashikuara në rregullat e prokurimit publik.”

III.1.5. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 41, përcaktohet se: *“Marrëveshje kuadër quhet një marrëveshje ndërmjet një apo më shumë autoriteteve kontraktore dhe një apo më shumë operatorëve ekonomikë, qëllimi i së cilës është të vendosë kushtet e kontratave që do të prokurohen gjatë një periudhe të caktuar kohore, veçanërisht ato që kanë lidhje me çmimin dhe, aty ku është e përshtatshme, me sasinë e parashikuara”.*

Në nenin 45, pika 2 të këtyre rregullave përcaktohet se:

“Operatorët ekonomikë përzgjidhen si palë të marrëveshjes kuadër duke zbatuar kriteret e përcaktimit të ofertës fituese, sipas përcaktimeve të nenit 55, të LPP-së. Në çdo rast, autoriteti kontraktor mund të vendosë të vlerësojë ofertën/ofertat fituese duke u bazuar në çmimin për njësi”

Ndërsa në nenin 47, pika 1 dhe 2, po këtu, parashikohet se:

1. *Marrëveshja kuadër mund të lidhet me:*

a) *një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara;*

b) *disa operatorë ekonomikë kur:*

- *të gjitha kushtet janë të përcaktuara;*
- *jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara.*

2. *Kontratat e bazuara në marrëveshjet kuadër të lidhura me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara duhet të akordohen brenda kufijve dhe kushteve të parashikuara në marrëveshjen kuadër. Në kontratat e bazuara në marrëveshjen kuadër nuk mund të bëhen ndryshime të kushteve për të cilat është lidhur marrëveshja, pasi kjo do të konsiderohej shkelje e marrëveshjes kuadër. Nëse nevojat e autoritetit kontraktor ndryshojnë, atëherë autoriteti kontraktor duhet të prokurojë një marrëveshje kuadër të re. Një operator ekonomik i kërkohet të përgatitë ofertën e tij vetëm në lidhje me kushtet për të cilat është rënë dakord paraprakisht në marrëveshjen kuadër.*

III.1.6. KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.7. Referuar sa më sipër KPP gjykon se në dokumentat e tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar shprehimisht mënyrën e vlerësimit dhe të krahasimit të ofertave, dhe u bën me dije ofertuesve se ofertat e tyre do të paraqitet si shumatore e cmimeve per njesi, te përllogaritur per cdo artikull, por gjithashtu do të paraqitet edhe vlera totale e ofertes. Për më tepër, autoriteti kontraktor ka sqaruar më hollësisht, nëpërmjet një shtojce në SPE, të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar për të paraqitur ofertë në procedurën e prokurimit, se oferta do të paraqitet si shumatore e cmimeve për njësi, të përllogaritur për cdo artikuj dhe vlera totale e ofertës nuk duhet të tejkalojë vlerën e fondit limit, ndaj për këtë arsye është

përcaktuar që OE mund të paraqesin preventivin edhe në vlerën totale të ofertës ekonomike, por kriter kryesor do të jetë shumatorja e cmimeve për njësi, përderisa është perzgjedhur lloji i procedurës së prokurimit, kërkesë për propozim – marrëveshje kuadër.

Në rastin konkret autoriteti kontraktor nuk ka vepruar sic ka njoftuar në dokumentat e tenderit, por ka bërë renditjen e ofertave, bazuar në cmimin total të ofertës pa tvsh, duke ndryshuar rregullat e vendosura nga ky i fundit në këto dokumenta, në kundërshtim me nenin 55, pika 2 të të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas të cilit autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k për procedurën e prokurimit me Nr.REF- 08993-02-18-2019, me objekt: “*Blerje kancelari (bojra + leter format, etj) per Bashkine dhe Njesite e Varesise per vitin 2019*”, “Marrëveshje kuadër”, me fond limit 1 315 864 lekë pa tvsh, zhvilluar ne daten 01.03.2019 nga autoriteti kontraktor Bashkia Librazhd.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë procedurën e prokurimit, bazuar kriteret e dokumentave të tenderit.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Infosoft Office” shpk
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 509 Protokoli,

Datë 20.03.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Enkeleda Bega	Vilma Zhupaj	Lindita Skeja	Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha